



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014  
Nr. Dok. 201302843/5

**Lënda:** *Rekomandojmë vendosjen e kamerave në disa ambiente të pamonitoruara të IEVP Durrës si dhe gjetjen e një zgjidhjeje teknike për monitorimin sa më të qartë të ambienteve të tjera në të cilat janë vendosur kamera.*

**Drejtuar:** Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve  
Z. Artur ZOTO

**TIRANË**

**Për dijeni:** Drejtorit të IEVP Durrës  
Z. Astrit KOTAJ

**DURRËS**

*I nderuar Zoti Zoto,*

Në zyrën e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa e të paraburgosurit M. K., i cili pretendonte se në datën 12.12.2013, ishte dhunuar fizikisht nga punonjës të policisë të IEVP Durrës. Sipas M. K., gjatë kohës që ai po pastronte koridorin e sektorit të dytë në katin e tretë, kishte patur thyerje të rendit nga të paraburgosur të tjerë dhe tre punonjës të policisë që kishin ardhur për të qetësuar situatën e kishin goditur me grushta dhe shkop gome. Dhuna fizike ka ndodhur në katin e tretë, në shkallët që çojnë në katin e parë dhe brenda dhomës së takimit me avokatin në koridorin e katit të parë.

Për verifikimin e kësaj ankese u morën në pyetje punonjësit e policisë që pretendohet se kishin ushtruar dhunë, u këqyrën dokumenta dhe pamje filmike të kamerave si dhe u kërkua ekzaminimi mjeko-ligjor i ankuesit. Në përfundim të hetimit nuk u provua pretendimi i të paraburgosurit Mario Kapedani.

Nga verifikimi i pamjeve filmike rezultoi se, jo të gjitha ambientet e IEVP Durrës, objekt i hetimit tonë, ishin të monitoruara me kamera. Ambientet e pamonitoruara ishin: një pjesë e shesh pushimit në katin e dytë, sheshpushimi në katin e tretë, zgara në katin e tretë dhe një pjesë e mirë e koridorit që çon

në dhomat e veçimit. Gjithashtu pamjet e kamerave në sektorët e katit të tretë nuk ishin të qarta për shkak të dritës që vinte nga ndriçuesit që kishin përballë.

Në ambientet e lartpërmendura janë kryer veprime nga i paraburgosuri Mario Kapedani dhe punonjësit e policisë të lidhur me çështjen nën shqyrtim. Këto veprime lidhen me pretendimet e ankuesit, si dhe do të kishin patur rëndësi për zbardhjen e të vërtetës.

Dhoma e takimit me avokatin në katin e parë në të cilën është dërguar Mario Kapedani dhe ku pretendohet se ai është dhunuar nuk është e monitoruar qartë në hyrjen e saj. Kamera e vendosur në katin e parë për të monitoruar këtë ambient e ka rrezën e pamjes të kufizuar dhe në të nuk arrihet të dallohen qartë lëvizjet që ndodhin në një pjesë të mirë të koridorit që çon për në dhomat e veçimit. Gjatë këtij koridori janë vendosur disa ambiente që shërbejnë për aktivitete dhe shërbime të ndryshme që ofron institucioni. Ky koridor në kamera duket i përfshirë në gjysëm errësirë.

Ky konstatim është bërë edhe më parë, gjatë hetimit një ankese për ushtrim dhune në IEVP Durrës, ngjarje e ndodhur në datën 11.09.2012. Me shkresën tonë Nr. K4/G8-8 Prot., datë 11.10.2012, patëm rekomanduar vendosjen e kamerave në ambientet e lartpërmendura dhe gjetjen e një zgjidhje për monitorimin sa më të qartë të disa ambienteve të tjera. Rekomandimi ynë nuk ka gjetur zbatim dhe hetimi i rastit në fjalë nxorri edhe një herë tjetër në pah domosdoshmërinë e monitorimit me kamera të disa ambienteve të brendëshme të IEVP Durrës.

Mbikqyrja me kamera e të gjitha ambienteve në IEVP, përveç atyre ambienteve që çenojnë privatësinë, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

Së dyti, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të burgjeve dhe paraburgime, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Për sa më lart, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike“*, në nenin 19, shkronja “b” të ligjit nr. 9094 datë 03.07.2003 *“Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”*, ku parashikohet se: *“Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka kompetencë t’u bëjë rekomandime organeve përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e personave, që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose*

dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues“, nenit 74/1 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", të ndryshuar, ku parashikohet se: "Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij, mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve.

*Mekanizmi Kombëtar ka këto kompetenca:*

a) vëzhgon rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues;

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues".

### **REKOMANDOJMË:**

1. Vendosjen e kamerave që të monitorojnë koridorin që çon në sheshin e ajrosjes, shesh pushimin e katit të dytë, sheshpushimin e katit të tretë, zgarën e katit të tretë dhe të gjithë koridorin që çon në dhomat e veçimit në IEVP Durrës;

2. Gjetjen e një zgjidhje për monitorimin sa më të qartë të koridorit të katit të tretë në regjimin e brendshëm të IEVP Durrës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nein 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**